

VENDIM
Nr. 209, datë 15.3.2017

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT
“RIKUALIFIKIM URBAN, SHESH, PARK PUBLIK, TEATRI ‘PETRO MARKO’”, NË
BASHKINË VLORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikualifikim urban, shesh, park publik, teatri ‘Petro Marko’”.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Vlorë.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë “tokë truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 81 331 044 (tetëdhjetë e një milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e dyzet e katër) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 81 331 044 (tetëdhjetë e një milionë e treqind e tridhjetë e një mijë e dyzet e katër) lekësh, të përballohet nga llogaria “Fondi i shpronësimeve”, në Bankën e Shqipërisë. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2017, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban.
 5. Detyrimet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij projekti të përballohen nga buxheti i shtetit.
 6. Shpronësimi të fillojë menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare.
 7. Pronarët e listës që i bashkëlidhen këtij vendimi të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Vlorë.
 8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Vlorë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit në hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
 9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit në hartën kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë, për pasuritë e shpronësuara.
 10. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë dhe Bashkia Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

LISTA E PASURIVE QË PREKEN NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIM URBAN, SHESH PARK PUBLIK TEATRI ‘PETRO MARKO’”

Çmimi i truallit sipas VKM-së nr. 89/2016

Çmimi për banesat konform VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, konfirmuar sipas ZVRPP -së

Çmimi për njësitë e shërbimit, konform VKM-së 138, datë 23.3.2000, sipas çmimeve të EKB-së

Nr.	ZK	Nr. i pasurisë	Adresa	Pronari	Sipërfaqe trualli	Sipërfaqe ndërtimi	Çmimi i truallit lekë/m²	Çmimi i ndërtimit lekë/m²	Vlera e truallit lekë	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truall dhe ndërtësë	Shënime
1	8603	23/9	Vlorë	Shtet (truall në shërbim të pallatit)	155.87							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	8603	23/10	Vlorë	Shtet	862.75							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	8603	23/47	Vlorë	Shtet (truall në shërbim të pallatit)	14.83							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
4	8603	23/100	Vlorë	Shtet	18.7							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
5	8603	23/105	Vlorë	Lulezim Begaj	69		10,903		752,307	0	752,307	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
6	8603	23/101-T	Vlorë	Bp Begaj	156		10,903		1,700,868	0	1,700,868	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
7	8603	23/105-ND	Vlorë	Lulezim Begaj		55						Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Objekti nuk ekziston, referuar relacionit shpjegues, bashkëlidhur.
8	8603	23/101-ND	Vlorë	Bashkim Begaj		108						Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Objekti nuk ekziston, referuar relacionit shpjegues, bashkëlidhur.
9	8603	22/64	Vlorë	Shtet	357.42							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
10	8603	23/98	Vlorë	Shtet	21.4							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
11	8603	23/99	Vlorë	Belina Fejzaj	200	160	10,903		2,180,600	2,559,028	4,739,628	Konfirmuar nga ZVRPP-ja Hipotekohet në favor të Bakës Kombëtare të Greqisë. Vlera e katit përdhe me destinacion njësi shërbimi dhënë sipas situacionit të punimeve.
						160		46,136.20	0	7,381,792	7,381,792	Vlera e katit të dytë me destinacion objekt

												banimi dhënë sipas çmimit të ZVRPP-së, zbritur vlera e truallit (shkresa bashkëlidhur)
12	8603	23/11-T	Vlorë	Shtet	108.4							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
13	8603	23/11-ND	Vlorë	Shtet		108.4	10,903	0	0	0	0	Konfirmuar nga ZVRPP-ja. Objekti nuk ekziston ne terren
14	8603	23/96	Vlorë	Shtet	2396							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
15	8603	23/66	Vlorë	Shtet	236.13							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
16	8603	22/98	Vlorë	Shtet (truall në shërbim të pallatit)	24.48							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
17	8603	22/112-ND	Vlorë	Objekt shtesë e banesë		15.65			0	758,978	2,276,934	Konfirmuar nga ZVRPP-ja, 3 kate
18	8602	1./9	Vlorë	Shtet shesh para teatrit “Petro Marko”	468.33							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
19	8602	1./22	Vlorë	Shtet	29.76							Konfirmuar nga ZVRPP-ja
20	8602	1./7	Vlorë	Shtet	72.17							Konfirmuar nga ZVRPP
21	8603	23/200	Vlorë	Artan Ferati	143	60.5	10,903		1,559,129	0	1,559,129	nuk ekziston objekti. Konfirmuara nga ZVRPP-ja. Urdhër kufizimi, referuar relacionit shpjegues bashkëlidhur
22	8603	23/210	Vlorë	Aleks Ahmataj	128.8	74.2	10,903		1,404,306	0	1,404,306	Nuk ekziston objekti. Konfirmuara nga ZVRPP-ja. Urdhër kufizimi, referuar relacionit shpjegues bashkëlidhur
23	8603	23/201	Vlorë	Mustafa Tartari	239	90	10,903		2,605,817	0	2,605,817	Nuk ekziston objekti. Konfirmuara nga ZVRPP-ja. Urdhër kufizimi, referuar relacionit shpjegues bashkëlidhur
24	8603		Vlorë	Objekt pallat me vendim të KRT- së V. Vlorë nr. 3/4, vitit 2010			10,903		0	58,910,263	58,910,263	Bashkia Vlorë me shkresën nr. 1767 prot., datë 3.3.2017, kërkon përfshirjen e objektit i cili ngrihet mbi pasuritë me nr. 23/200, 23/201, 23/210. Sipas verifikimit faktik, objekti është 5

													kate dhe i papërfunduar. Pasuria do të përfshihet për likuidim pas mbarimit të procesit gjyqësor, regjistrimit në ZVRPP dhe marrjes së certifikatës së pronësisë
--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--	--

81.331.044